



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 262 , Datë 21.12.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ELVA 2001” SH.A., PËR TRANSFERIMIN E
ASETEVE TË PALUAJTSHME (VENDOSJE HIPOTEKE) NË FAVOR TË “INTESA
SANPAOLO BANK ALBANIA” SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, pika “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 1.3 dhe pikës 1.6, të “Licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 99, datë 17.06.2016; nenit 11, të Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 156/11 prot., datë 17.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., për transferimin e asetëve të paluajtshme (vendosje hipoteke) në favor të “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” sh.a.”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 230, datë 15.11.2021, ka vendosur të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen mbi kërkesën e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., për transferimin e asetëve të paluajtshme (vendosje hipoteke), në favor të “INTESA SAN PAOLO BANK” sh.a.
- Kjo vendimmarrje erdhi për shkak të nevojës së sqarimit të diferencës ndërmjet vlerës së principalit të kredive dhe vlerës së asetëve për të cilat shoqëria ka paraqitur kërkesën në ERE për t’i vendosur si mjete garantuese të këtyre kredive, si dhe për të sqaruar qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në lidhje me nevojën e marrjes ose jo të miratimit të saj mbi këtë transferim.
- Me qëllim sqarimin e sa më sipër dhe orientimin e drejtë të vendimmarrjes së bordit, ERE me shkresën nr. 767/15 prot., datë 25.11.2021, ka njoftuar shoqërinë “ELVA 2001” sh.a., MIE-n, si dhe “INTESA SANPAOLO BANK” sh.a., për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 09.12.2021. Në seancë morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha palëve të ftuara.

- Në lidhje me diferencën e konsiderueshme mes vlerës totale të principalit të kredive të kontratave të kredive bankare dhe vlerës totale të aseteve të paluajtshme mbi të cilat do të vendoset hipoteka, përfaqësuesit e shoqërisë deklaruan në seancë se kontratat e kredive me bankën janë nënshkruar në vitin 2019, vit në cilin HEC-i nuk ishte ndërtuar ende dhe nuk dihej me saktësi vlera që do të kishin asetet e tij, por i janë referuar raportit “Due diligence” dhe vlerës që ka rezultuar kur është nënshkruar kontrata. Përfaqësuesit e bankës “INTESA SANPAOLO BANK” sh.a. deklaruan se vlera e kolateralit është e negociuar dhe dakordësuar me shoqërinë dhe si çdo praktikë tjetër e ngjashme, është bërë marrëveshje mes palëve nënshkruese, por edhe në rast se shoqëria nuk do të përmbushë detyrimi sipas përcaktimeve dhe në afat, banka do të fillojë ekzekutimin vetëm për principalin dhe jo për të gjithë kolateralin e vendosur si garanci. Përfaqësuesit e shoqërisë konfirmuan sa deklaruar nga banka dhe se kanë rënë dakord që të vendosin si kolateral të gjitha asetet e HEC-it për të garantuar shlyerjen e kredive.
- Përsa i përket qëndrimit të MIE-s, përfaqësuesi i saj deklaroi në seancë se në bazë të përcaktimeve të kontratës nr. 5 Rep., Nr. 3/3 Kol, datë 25.01.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Hidrocentralit “Mivas” me kapacitet prodhues 1.940 MW, në pellgun ujëmbledhës të lumit Tomoricë, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”, të nënshkruar mes MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., kjo e fundit nuk është e detyruar për të marrë autorizimin e MIE-s në rast të transferimit të aseteve të HEC-it, pasi kontrata e nënshkruar me këtë shoqëri nuk është kontratë koncesionare dhe këto asete nuk janë pronë e MIE-s, por e shoqërisë. Kjo kontratë vendos kufizime vetëm për transferim të kapitalit dhe aksioneve të shoqërisë tek të tretët, pasi kjo lidhet me faktin që MIE njeh këtë shoqëri si palë kontraktore.
- Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëria në kuadër të kërkesës për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin e aseteve, rezulton se ajo ka nënshkruar kontratat përkatëse të hipotekës me bankën “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” sh.a. ndaj në saktësim të mjeteve garantuese të detyrimit për të cilat kanë nënshkruar të dyja palët (shoqëria dhe banka), ERE shprehet vetëm për transferimin e aseteve të paluajtshme (vendosje hipoteke) të HEC MIVAS.
- Nga analizimi i aplikimit të shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., në zbatim të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se ai është plotësuar tërësisht.
- Shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera, kur kjo kërkohet nga këto organe.
- Shoqëria ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., për transferim të asetëve të paluajtshme (vendosje hipoteke), në favor të “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” sh.a..
2. Shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratime përkatëse nga organet e tjera, kur kjo kërkohet nga këto organe.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI